



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 126, Datë 02/08/2016

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KONSTATON:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërmat “a” dhe “c”, dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur të gjithë hapat administrativë që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën nr. 10, datë 20.01.2016, e Shoqatës “Aleanca kundër Diskriminimit LGBT”, përfaqësuar nga Znj.

Mari, ku pretendohet diskriminim për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të dy aktivistëve LGBT, përkatësisht të Z. *Blendi Hoxha* (të ashtuquajturës *Andybeia*, e cila është transgjimore) dhe Znj. *Blendi Hoxha* nga ana e e ay punonjësve të policisë së Drejtorisë Vendore Shkodër, përkatësisht nga ana e policëve *Blendi Hoxha* dhe *Dedë Shkoza*.

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në përfundim të procedurës së hetimit ka dalë Vendimi nr. 71, datë 27.04.2016, i Komisionerit, me anë të të cilit është vendosur, si më poshtë:

1. “Konstatimin e diskriminimit, për shkak të identitetit gjinor, të Z. *Blendi Hoxha* nga ana e punonjësit të policisë *Blendi Hoxha* me detyrë trupë shërbimi, Patrullë e Përgjithshme në Seksionin e Rendit të Sigurisë, të Komisarariatit të Policisë Shkodër.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Policisë Vendore Shkodër, që ngjarje të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.
3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, punonjësi i policisë *Blendi Hoxha*, të kërkojë falje ndaj Z. *Blendi Hoxha* për shprehjet diskriminuese të përdorura ndaj tij.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Drejtoria e Policisë Vendore Shkodër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni”.

Për sa më sipër, Policia Vendore Shkodër ka marrë dijani për Vendimin nr. 71, datë 27.04.2016, e Komisionerit, por edhe pse ka kaluar afati ligjor, nuk e ka zbatuar rekomandimin e tij dhe nuk i ka kthyer asnjë përgjigje Komisionerit lidhur me pikat 2 dhe 3 të Vendimit.

Me shkresën nr. Nr. 3679/1, datë 16.06.2016, Policia Vendore Shkodër e informoi Komisionerin si më poshtë vijon: “Pas komunikimit të vendimit Tuaj nr. 71, datë 27.04.2016, që lidhet me ngjarjen e ndodhur në datën 19.01.2016, punonjësi i policisë inspektor *[Emri i punonjës]*, shprehet se:

“...Nuk jam dakord, që ti kërkoj të falur shtetasit *[Emri i shtetasit]*, pasi unë kam qenë në detyrë dhe të gjitha veprimet e mia janë në përputhje me ligjin. “Te gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë, janë të barabartë para ligjit”. Mbështetur në rregulloren e Policisë së Shtetit, për këtë ngjarje jam ndërshtuar me “masë parandaluese”, nga titullari i institucionit me Vendimit nr. 762, datë 01.04.2016.....”.

Për sa më sipër, Policia Vendore Shkodër nuk dërgoi asnjë informacion, edhe mbi zbatimin e pikës 2, të Vendimit nr. 71, datë 27.04.2016, të Komisionerit, lidhur me masat që do të merrte në vijim, që ngjarje të tilla, si ajo e datës 19.01.2016, të mos përsëriteshin më në të ardhmen.

Për sa më sipër, Komisioneri iu drejtua sërish Policisë Vendore Shkodër me shkresën nr. 686, datë 04.07.2016, ku iu kërkua plotësimi i masave të përcaktuara në Vendimin e KMD-së, pasi në rast të kundërt, mbështetur në nenin 33, pika 11¹, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, do të zbatohet ndërshtimi me gjobë. Në vijim, institucioni i sipërpërmendur nuk dërgoi asnjë përgjigje në adresë të KMD-së.

Në këto kushte, Komisioneri konstaton se Policia Vendore Shkodër dhe punonjësi i policisë Z. Dedë Shkoza nuk e kanë zbatuar Vendimin nr. 71, datë 27.04.2016, e Komisionerit dhe janë në shkelje të pikës 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet:

¹ Në nenin 33, pika 11, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet: “Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.”



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

"Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni".

PËR KËTË ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma "ç", nenin 33, pikat 10, 11, 12, 13/b të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Policia Vendore Shkodër të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Z. ~~.....~~, punonjës i Policisë Vendore Shkodër të gjobitet në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë.
3. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i Vendimit nr. 71, datë 27.04.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
5. Policia Vendore Shkodër duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij Vendimi.
6. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim sipas ligjit.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 686 Prot.

Tiranë, më 09/10/2016

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar: Z. SHKODËR
Drejtor i Policisë Vendore

SHKODËR

I nderuar Z. SHKODËR

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 3679/1, datë 16.06.2016, Komisioneri ju bën me dije se vendimet e tij janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe mund të kundërshtohen vetëm pranë gjykatës kompetente.

Pavarësisht masës disiplinore që i është dhënë punonjësit Z. SHKODËR nga titullari i tij për shkelje të normave të etikës në komunikim dhe mosrespektim të Procedurave Standarte të Punës, me Vendimin nr. 71, datë 27.04.2016, e Komisionerit, veprimet e Z. SHKODËR janë konsideruar diskriminuese, kundrejt shtetasit Z. SHKODËR.

Masat, që përmban Vendimi i Komisionerit janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Në rast të kundërt, mbështetur në nenin 33, pika 11¹, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", punonjësi i policisë Z. SHKODËR do të gjobitet sipas dispozitave përkatëse të ligjit të sipërpërmendur.

¹ Në nenin 33, pika 11, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", parashikohet: "Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni."



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web:www.kmd.al

Për sa më sipër, të njoftohet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda datës ___/___/2016, lidhur me zbatimin e Vendimit nr. 71, datë 27.04.2016.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Irma BARAKU

KOMISIONERI



Adresa: Rruga Sami Frasherit, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)

Tel: +355 4 2431078

Fax: +355 4 2431077

e-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al